

V E N D I M
Nr. 55, datë 24.2.2000

PËR SHITESË FONDESH MINISTRISË SË PUSHTETIT LOKAL

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 21 dhe 27, të ligjit nr. 8379, datë 29.7.1998, “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Pushtetit Lokal, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

1. Ministrisë së Pushtetit Lokal në buxhetin e vitit 2000, i shtohen 10 milionë lekë, për blerjen e dy objekteve brenda territorit të objektit ish-hotel “Drini”.
 2. Fondi për blerjen e objekteve të mësipërme të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
 3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Pushtetit Lokal për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta